



Shkurt / Februar 2018

alban.

Duani njëri tjetrin, ashtu siç unë ju desha ju!

(Gjon 15,12)

**Zoti është ne.
God is us!**

„Freunde des Wortes“

Kontakt: Meinolf Wacker
Kirchplatz 7
59174 Kamen

Tel.: 0049-172-5638432

Mail: mail@onword.de

homepage www.onword.de

Të dashur miq të fjalës,

Të vijmë në gjurmët e Zotit është një aventurë e vërtetë. Por të zbulosh fantazinë e tij është e pafundme! Unë mendoj në vajzën e re myslimane, e cila kishte gjetur filmin tonë „be brother - be sister“ në internet. Ajo donte të na njihje ne. Rrënjët e saja ishin në Shqipëri, por ajo ishte rritur në Dubai, me pasaportë Siriane dhe studioje tani në Berlin. Ajo më telefonoi. Ne u takuam tek një stacion treni dhe pimë së bashku një kafe. Me sytë e saj të mëdhenj dhe kureshtar më shikonte ajo poshtë shamisë së saj. Që në momentin e parë të takimit tonë unë ndjeja një atmosferë plot besim. Pamenduar ndjenji ajo në një celebrim, për të cilin unë kisha shkuar drejt Berlinit. Në darkë unë e solla atë përsëri tek stacioni. Pak me turp ajo më drejtoj një pyetje. „Unë nuk besoj se ju të krishterët besoni në tre Zotë, por unë nuk ju kuptoj! A mund të më ndihmosh në këtë?“

Në sytë e saj kureshtar unë i thashë: „Ti ke një pyetje në zemër. Midis meje dhe teje ka lindur një besim, që ty të dha kurajon të më bëje këtë pyetje. Kjo pyetje lëshon në mua një përgjigje. A e ndjen këtë dinamikë mes nesh?“ Ajo pohonte me kokë. „Ne të krishterët besojmë, se jemi bërë në përngjasim të Zotit. Dhe Zoti në vetvete është një lidhje. Ati, i cili jeton duke dhuruar, që është shpirti i shenjtë, për të birin. Dhe i biri jeton po ashtu për të Atin. Në Zotin – kështu besojmë ne – ndodh me të vërtetë diçka. Jetë dhe dinamikë e pastër – nga e cila u krijua gjithë bota. Zoti është NE. Dhe kur ne bashkë, si tani, jetojmë këtë NE, jemi të lumtur“ Lotët mbushën sytë e saj. Ajo dukej shumë e prekur. Para se të hipte në tren ajo më tha: „Këtë ndriçim nuk do ta harroj asnjëherë!“

Të dashur miq të fjalës, Zoti – këtë na e la Jezusi ne ta kuptojmë – është në vetvete një lidhje. Ai është NE. Të bëjmë edhe ne të njëjtën gjë për të dhe të jetojmë më shumë bashkë sesa vetem. Dhe të jemi të sigurtë, se në këtë rrugë do të gjejmë lumturinë, si unë munda ta gjej në momentet me Aman, vajzën e re nga Siria, **Zoti është NE! – God is us!**

për OnWordTeam

Meinolf Wacker